



# FLETORJA ZYRTARE

## E

### REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr. 58**

**2003**

**Korrik**

#### P Ë R M B A J T J A

|                                       |                                                                                                                                                                                                          | Faqe |
|---------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Dekret nr.3832<br>datë 5.6.2003       | Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....                                                                                                                                                             | 2449 |
| Dekret nr.3893<br>datë 17.7.2003      | Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e pushtetit<br>vendor.....                                                                                                                                | 2450 |
| Vendim i KM<br>nr.449, datë 26.6.2003 | Për tarifat në sektorin e pyjeve dhe të kullotave.....                                                                                                                                                   | 2450 |
| Vendim i KM<br>nr.464, datë 3.7.2003  | Për disa ndryshime në vendimin nr.288, datë 18.6.1999 të<br>Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit të<br>politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve në<br>Republikën e Shqipërisë”..... | 2455 |
| Vendim i KM<br>nr.465, datë 3.7.2003  | Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i<br>modernizimit të Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror,<br>sh.a.....                                                                       | 2456 |
| Vendim i KM<br>nr.473, datë 10.7.2003 | Për mënyrën e përdorimit të flamurit kombëtar në mjediset<br>e jashtme dhe të brendshme, të institucioneve publike, si<br>dhe raporti i përmasave të tij.....                                            | 2457 |

|                                         |                                                                                                                                                                                                                                            |      |
|-----------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i KM<br>nr.474, datë 10.7.2003   | Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj.....                                                                                                                                                  | 2460 |
| Vendim i KM<br>nr.475, datë 10.7.2003   | Për miratimin e rregullores “Për karakteristikat e vajrave të ullirit”.....                                                                                                                                                                | 2466 |
| Vendim i KM<br>nr.477, datë 10.7.2003   | Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Vorë-Mamurras, pjesë e superstradës Tiranë-Durrës.....                                                                         | 2474 |
| Vendim i GJK<br>nr.21, datë 10.7.2003   | Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.39, datë 24.4.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr.237, datë 24.9.2002 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.3, datë 8.1.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushetuese..... | 2477 |
| Vendim i KKRT<br>nr.144, datë 27.6.2003 | Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “CNA”                                                                                                                                                                                   | 2480 |
| Vendim i KKRT<br>nr.145, datë 27.6.2003 | Mbi licencën për radio FM vendore private “KOHA”.....                                                                                                                                                                                      | 2480 |

**D E K R E T**  
**Nr.3832, datë 5.6.2003**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

**D E K R E T O J:**

**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- |                                         |                                    |
|-----------------------------------------|------------------------------------|
| 1. Sofije Alush Çela                    | 33.Florian Agim Sulejmani          |
| 2. Erida Engjëll Bano                   | 34.Semiha Hamit Myftiu             |
| 3. Mikel Engjëll Bano                   | 35.Olta Lavdosh Ahmeti             |
| 4. Platon Nazmi Daiu                    | 36.Edmond Mustafa Rruga            |
| 5. Engel Platon Daiu                    | 37.Julia Edmond Rruga              |
| 6. Liljana Hysni Daiu (Karamani)        | 38.Sara Edmond Rruga               |
| 7. Artan Hasan Weymann (Muça)           | 39.Irina Abdulla Rruga (Rama)      |
| 8. Luan Fiqiri Koçi                     | 40.Luljeta Hamdi Böttcher (Nurka)  |
| 9. Liljana Mitro Przybilla (Llavdoniti) | 41.Mimoza Shaban Irmisch (Allushi) |
| 10.Valbona Noi Mehrwald (Feka)          | 42.Menada Ibrahim Celia (Reli)     |
| 11.Lulzim Riza Koliqi                   | 43.Muzhak Dilaver Fama             |
| 12.Klaudia Lulzim Koliqi                | 44.Xhesika Muzhak Fama             |
| 13.Maik Lulzim Koliqi                   | 45.Sanie Hajrulla Fama (Kuqo)      |
| 14.Drita Dalip Koliqi (Sulozeqaj)       | 46.Lizandër Muzhak Fama            |
| 15.Doris Lulzim Koliqi                  | 47.Gëzim Mehmet Avdyli             |
| 16.Ferdinant Petrit Sageri              | 48.Irida Gëzim Avdyli              |
| 17.Eliona Shëndet Sageri (Skënderi)     | 49.Kadrie Zhelal Avdyli (Hyseni)   |
| 18.Islam Haxhi Muzhaqi                  | 50.Skënder Rexhep Balluku          |
| 19.Elga Islam Muzhaqi                   | 51.Andreas Skënder Balluku         |
| 20.Lorena Islam Muzhaqi                 | 52.Eleni Koço Balluku (Konini)     |
| 21.Renata Muharrem Muzhaqi (Luca)       | 53.Gerd Skënder Balluku            |
| 22.Kristo Lame Luzi                     | 54.Mimoza Hajdar Waibel (Allkja)   |
| 23.Melita Hasan Duma                    | 55.Edmond Bardhok Toto             |
| 24.Xhenis Adrian Duma                   | 56.Majlinda Islam Suli (Pepa)      |
| 25.Vasil Llambri Kallupi                | 57.Kristi Halim Suli               |
| 26.Dëshira Ali Kallupi (Agolli)         | 58.Hamila Halim Suli               |
| 27.Anxhelo (Angelo) Pavlo Golgota       | 59.Arben Ali Qordja                |
| 28.Klodiana Isa Golgota (Ferra)         | 60.Afrim Rakip Shini               |
| 29.Sulltane Riza Mazarin-Kaja           | 61.Ariona Afrim Shini              |
| 30.Rudina Qamil Sulejmani (Hushi)       | 62.Renaldo Afrim Shini             |
| 31.Alvaro Agim Sulejmani                | 63.Armonela Ahmet Shini (Kuka)     |
| 32.Florida Agim Suljmani                | 64.Julian Thimio Boçi              |

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Alfred Moisiu**

**D E K R E T**  
**Nr.3893, datë 17.7.2003**

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E PUSHTETIT VENDOR**

Në mbështetje të nenit 92 germa “gj” të Kushtetutës, si dhe të nenit 181 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”

**D E K R E T O J:**

**Neni 1**

Zgjedhjet për organet e pushtetit vendor të zhvillohen ditën e dielë, datë 12 tetor 2003.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Alfred Moisiu**

**V E N D I M**  
**Nr.449, datë 26.6.2003**

**PËR TARIFAT NË SEKTORIN E PYJEVE DHE TË KULLOTAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, të neneve 28 e 37 të ligjit nr.7623, datë 13.10.1992 “Për pyjet dhe Policinë e Shërbimit Pyjor” dhe të nenit 25 të ligjit nr.7917, datë 13.4.1995 “Për kullotat dhe livadhet”, me propozimin e Ministrisë të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Tarifat bazë për shitjen e lëndës drusore në këmbë, të jetë sipas lidhjeve 1/a dhe 1/b, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Shitja e lëndës drusore të bëhet me ankand. Procedurat e zhvillimit të tij të përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

2. Tarifat për prodhimet e dyta në pyje dhe kullota të jenë sipas lidhjes 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Tarifat për pyllëzimet e miratuara në fondin pyjor të jenë sipas lidhjes 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Tarifat për përdorimin e pyjeve dhe të kullotave për qëllime pushimi, shëndetësore, turizmi etj. dhe për ngritjen e kampingjeve, të qendrave dhe objekteve të tjera të lëvizshme, në fondin pyjor e kullosor, të jenë sipas lidhjes 4/a dhe 4/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Tarifat për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor të jenë sipas lidhjes 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Vendimi nr.82, datë 26.2.1993 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

Lidhja 1/a

### TARIFAT BAZË TË SHITJES ME ANKAND TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË

| Nr. | Emërtimi                                                                                                              | Njës.matj. | Tarifa (lekë)      |                                |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|--------------------|--------------------------------|
|     | I. Lëndë punimi në këmbë                                                                                              |            | e hollë deri 22 cm | e mesme dhe e trashë mbi 22 cm |
|     | a. Halorë                                                                                                             |            |                    |                                |
| 1   | Pishë                                                                                                                 | m3         | 1600               | 2200                           |
| 2   | Bredh                                                                                                                 | m3         | 1600               | 2200                           |
|     | b. Fletore                                                                                                            |            |                    |                                |
| 1   | Ah                                                                                                                    | m3         | 1300               | 2400                           |
| 2   | Dushk                                                                                                                 | m3         | 1500               | 2700                           |
|     | II. Dru zjarri                                                                                                        |            |                    |                                |
|     | a. Të forta                                                                                                           |            |                    |                                |
|     | 1. Dushk, ah, panjë, frashër, rrap, akacie, lofatë, gështenjë,shkozë, bli, mare, lajthi, thanë dhe bush<br>b. Të buta | m3         | 160                |                                |
|     | 1. Halorë, shelg, plep dhe vërri                                                                                      | m3         | 80                 |                                |

Lidhja 1/b

### TARIFAT BAZË TË SHITJES ME ANKAND TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË

| Nr. | Emërtimi                                            | Njës. Matj. | Tarifa (lekë) |      |
|-----|-----------------------------------------------------|-------------|---------------|------|
|     | Lëndë druri në këmbë                                |             |               |      |
| 1   | Arrë, gështenjë, panjë, vidh                        | m3          |               | 4500 |
| 2   | Carac,ekualipt,man,mëllëzë, plep,rrap,shelg, shkozë | m3          |               | 1700 |
| 3   | Bli,frashër,gështenjë e egër, mështeknë, vërri      | m3          |               | 3300 |

Lidhja 2

### TARIFAT E PRODHIMEVE TË DYTË

| Nr. | Emërtimi                                          | Njës. Matjes | Tarifa (lekë) |
|-----|---------------------------------------------------|--------------|---------------|
| 1   | Fashina, shkarpa                                  | mst          | 35            |
| 2   | Thupra të çdo lloji                               | kv           | 55            |
| 3   | Kucka, rrënjë                                     | kv           | 100           |
| 4   | Cungje                                            | m3           | 150           |
| 5   | Hunj                                              | 000/copë     | 160           |
| 6   | Bandiera                                          | 000/copë     | 290           |
| 7   | Eshkë kovaçi                                      | kv           | 90            |
| 8   | Qymyr druri                                       | kv           | 700           |
| 9   | Katran                                            | kv           | 700           |
| 10  | Rrëshirë pishe                                    | kv           | 350           |
| 11  | Nxjerrja në sipërfaqen e fondit pyjor e kullosor: |              |               |
|     | a) Gurë, rrëzë dhe zhavor                         | m3           | 35            |
|     | b) Dhe dhe humus                                  | m3           | 60            |
| 12  | Grumbullim në fondin pyjor e kullosor:            |              |               |

|    |                                        |    |      |
|----|----------------------------------------|----|------|
|    | a) Bar                                 | kv | 20   |
|    | b) Gjeth                               | kv | 40   |
| 13 | Grumbullim në fondin pyjor e kullosor: |    |      |
|    | a) Lule të ndryshme                    | kv | 450  |
|    | b) Gjethë të ndryshme                  | kv | 150  |
|    | c) Rrënjë të ndryshme                  | kv | 250  |
|    | d) Herba të ndryshme                   | kv | 70   |
|    | e) Fruta, fara dhe sytha               | kv | 500  |
|    | f) Lëvore                              | kv | 350  |
| 14 | Grumbullim në fondin pyjor e kullosor: |    |      |
|    | a) Kërpudha                            | kv | 2500 |
|    | b) Boçe të ndryshme                    | kv | 1000 |

Lidhja 3

#### TARIFAT PËR SHPYLLËZIMET E MIRATUARA NË FONDIN PYJOR

Tarifat për shpyllëzimet e miratuara në fondin pyjor sipas destinacionit përbëhet nga:

1. Vlera e tokës e përcaktuar sipas ligjit mbi tokën për dhënie në pronësi dhe përdorim.
2. Vlera e pyllit, florës tjetër, faunës dhe vlerave të tjera që do të përcaktohen sipas studimeve të veçanta.

Lidhja 4/a

#### TARIFAT PËR PËRDORIMIN E PYJEVE DHE KULLOTAVE PËR QËLLIME PUSHIMI, TURISTIKE E TË TJERA

| Nr.ren. | Emërtimi i aktivitetit | Tarifa<br>(Lekë/vit/ha) |
|---------|------------------------|-------------------------|
|---------|------------------------|-------------------------|

|    |                              |            |
|----|------------------------------|------------|
| 1. | Pushime turistike e të tjera | 10 000 000 |
|----|------------------------------|------------|

Lidhja 4/b

#### TARIFAT PËR NGRITJEN E KAMPINGJEVE, QENDRAVE DHE OBJEKTEVE TË TJERA TË LËVIZSHME

| Nr. ren. | Emërtimi | Tarifa<br>(lekë/ditë/copë) |
|----------|----------|----------------------------|
|----------|----------|----------------------------|

|    |                    |     |
|----|--------------------|-----|
| 1. | Çadra deri 4 vende | 100 |
| 2. | Çadra mbi 4 vende  | 200 |
| 3. | Ruletë             | 500 |
| 4. | Barakë portative   | 250 |

Lidhja 5

#### TARIFAT E SHPËRBLIMIT TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NË FONDIN PYJOR

| Nr. | Emërtimi i dëmit                                 | Njësia e matjes | Vlera (lekë) |
|-----|--------------------------------------------------|-----------------|--------------|
| 1   | Prerje fidanësh, lastarësh e drurësh me diametër |                 |              |

|                                                                                  |                                                                                      |      |           |
|----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|------|-----------|
|                                                                                  | deri në 2 cm                                                                         | copë | 250       |
|                                                                                  | nga 2.1- 4 cm                                                                        | copë | 500       |
|                                                                                  | nga 4.1- 6 cm                                                                        | copë | 2 700     |
|                                                                                  | nga 6.1- 8 cm                                                                        | copë | 3 100     |
|                                                                                  | nga 8,1- 10 cm                                                                       | copë | 5 400     |
|                                                                                  | nga 10,1- 20 cm                                                                      | copë | 8000      |
|                                                                                  | nga 20,1- 30 cm                                                                      | copë | 15 000    |
|                                                                                  | nga 30.1- 40 cm                                                                      | copë | 20 000    |
|                                                                                  | nga 40.1-60 cm                                                                       | copë | 24 000    |
|                                                                                  | mbi 60 cm                                                                            | copë | 34 000    |
| 2                                                                                | Prerje fidanësh, lastarësh e drurësh në masë                                         |      |           |
|                                                                                  | në pyje të rinj (deri në 20 cm diametër)                                             | ha   | 650 000   |
|                                                                                  | në pyje të rritur (deri në 10 cm diametër)                                           | ha   | 125 000   |
|                                                                                  | shkurre                                                                              | ha   | 400 000   |
| Shënim: Prerje në masë quhet prerja e mbi 50% të drurëve në njësi të sipërfaqes. |                                                                                      |      |           |
| 3                                                                                | Dëmtim me çfarëdo mënyre i fidanëve, filizave e drurëve me diametër                  |      |           |
|                                                                                  | deri në 2 cm                                                                         | copë | 320       |
|                                                                                  | nga 2.1- 4cm                                                                         | copë | 540       |
|                                                                                  | nga 4.1-6 cm                                                                         | copë | 760       |
|                                                                                  | nga 6.1- 8 cm                                                                        | copë | 950       |
|                                                                                  | nga 8.1-10 cm                                                                        | copë | 1250      |
|                                                                                  | nga 10.1- 20 cm                                                                      | copë | 1600      |
|                                                                                  | nga 20.1 – 30cm                                                                      | copë | 2200      |
|                                                                                  | nga 30.1- 40 cm                                                                      | copë | 2700      |
|                                                                                  | nga 40.1 cm- 60cm                                                                    | copë | 3200      |
|                                                                                  | mbi 60cm                                                                             | copë | 5400      |
| 4                                                                                | Dëmtim në masën mbi 50% të sipërfaqes me çfarëdo mënyre                              |      |           |
|                                                                                  | në pyllëzimet e reja, pyjet e rinj e fidanishte:                                     | ha   | 320 000   |
|                                                                                  | në pyje të rinj mbi 10 cm diametër)                                                  | ha   | 630 000   |
|                                                                                  | në shkurre                                                                           | ha   | 108 000   |
| 5                                                                                | Dëmtime nga zjarri                                                                   |      |           |
| a                                                                                | kur vlerësohet materiali drusor                                                      |      |           |
|                                                                                  | në trungishte                                                                        | ha   | 250 000   |
|                                                                                  | në cungishte                                                                         | ha   | 80 000    |
|                                                                                  | në shkurre                                                                           | ha   | 50 000    |
|                                                                                  | në pyllëzime dhe fidanishte                                                          | ha   | 200 000   |
| b                                                                                | kur materiali drusor është dëmtuar plotësisht                                        |      |           |
|                                                                                  | në trungishte                                                                        | ha   | 1 500 000 |
|                                                                                  | në cungishte                                                                         | ha   | 700 000   |
|                                                                                  | në shkurre                                                                           | ha   | 400 000   |
|                                                                                  | në pyllëzime dhe fidanishte                                                          | ha   | 1 200 000 |
| 6                                                                                | Shpyllëzimi i fondit pyjor ose i pyjeve pa miratimin përkatës, pa përdorimin e tokës |      |           |
|                                                                                  | në trungishte                                                                        | ha   | 7 000 000 |
|                                                                                  | në cungishte                                                                         | ha   | 4 000 000 |
|                                                                                  | në shkurre                                                                           | ha   | 2 000 000 |
|                                                                                  | në pjesë të tjera të fondit pyjor                                                    | ha   | 1 500 000 |
| 7                                                                                | Zënie ose përdorim pa leje i fondit pyjor ose i pyjeve pa i dëmtuar ato              | ha   | 2 500 000 |
| 8                                                                                | Përvetësimi dhe shitja pa leje                                                       |      |           |

|    |                                                                                                                                                          |       |        |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|--------|
|    | lëndë punimi                                                                                                                                             | m3    | 60 000 |
|    | dru zjarri                                                                                                                                               | mst   | 30 000 |
|    | dru zjarri ngarkesë kali                                                                                                                                 | barrë | 9000   |
|    | dru zjarri ngarkesë gomari                                                                                                                               | barrë | 6000   |
|    | dru zjarri ngarkesë njeriu                                                                                                                               | barrë | 3500   |
|    | hunjtë ndryshëm deri në diametër 4 cm                                                                                                                    | copë  | 1400   |
|    | bandiera, bishta veglash, furde e furka e të tjera si këto me diametër 4,1-12 cm                                                                         | copë  | 4000   |
| 9  | Prodhim, përvetësim dhe shitje pa leje                                                                                                                   |       |        |
| a  | fruta e fara                                                                                                                                             | kg    |        |
|    | të njoma                                                                                                                                                 | kg    | 2300   |
|    | të thata                                                                                                                                                 | kg    | 4500   |
| b  | rrëshirë pishe e katran                                                                                                                                  | kg    | 1200   |
| c  | fletë dafine                                                                                                                                             |       |        |
|    | të njoma                                                                                                                                                 | kg    | 2300   |
|    | të thata                                                                                                                                                 | kg    | 4500   |
| d  | bimë mjekësore e tanifere                                                                                                                                |       |        |
|    | të njoma                                                                                                                                                 | kg    | 5400   |
|    | të thata                                                                                                                                                 | kg    | 10 000 |
| e  | rrënjë e kucka shqope, mare, bushi e të tjera si këto                                                                                                    | kg    | 10 000 |
| f  | thupra shëlgje e lloje të tjera të kësaj natyre                                                                                                          |       |        |
|    | të njoma                                                                                                                                                 | kg    | 1100   |
|    | të thata                                                                                                                                                 | kg    | 2000   |
|    | të zhveshura                                                                                                                                             | kg    | 3000   |
| g  | qymyr druri, eshkë kovaçi e të tjera të kësaj natyre                                                                                                     | kv    | 30 000 |
| h  | fuçi, kade, govata druri e të tjera të kësaj natyre, pavarësisht nga madhësia                                                                            | copë  | 15.000 |
| i  | kosha, shporta e të tjera të kësaj natyre prej thuprash shëlgje e lloje të tjera pyjore, pavarësisht nga madhësia                                        | copë  | 10 000 |
| 10 | Ndërtim pa leje i furrave të gëlqeres, kamina për qymyr druri, eshkë kovaçi, katrani e të tjera të kësaj natyre, pavarësisht nga madhësia                | copë  | 8000   |
| 11 | Dëmtimi ose zhdukja e objekteve të mbarështimit, gjeodezike e topografike dhe të tjera të kësaj natyre, në fondin pyjor                                  | copë  | 5400   |
| 12 | Dëmtimi ose zhdukja e ndërtimeve apo strehimeve për shtimin e gjahut e të tjera si këto, kudo që ndodhen.                                                | copë  | 10 800 |
| 13 | Dëmtimi ose zhdukja e pikave dhe kullave të vrojtimit për ruajtjen e florës dhe faunës, sëmundjet, insektet dhe zjarret                                  | copë  | 8000   |
| 14 | Dëmtimi i rrethimeve në fondin pyjor ose vende të tjera si këto                                                                                          | ml    | 5400   |
| 15 | Kryerja e gjurmimeve ose punimeve të tjera në fondin pyjor për nxjerrjen e gurëve, rrëzës, zhavorit, dheut, humusit, plisave të barit e të tjera si këto | m2    | 7000   |
| 16 | Hapja e gropave pa leje dhe mosmbulimi i tyre                                                                                                            | m3    | 4500   |
| 17 | Shkulja e cungjeve pa leje                                                                                                                               | copë  | 27 000 |
| 18 | Hapja pa leje në fondin pyjor e gurëve e të tjera si këto                                                                                                | m2    | 45 000 |
| 19 | Hapja e rrugëve, linjave telefonike, telegrafike,                                                                                                        | m3    | 49 500 |

|    |                                                                                                                                                                  |       |      |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|------|
|    | televizive, gazsjellëse, naftësjellëse, kanaleve, linjave të tensionit të lartë, ujësjellësive e të tjera të kësaj natyre në fondin pyjor, pa miratimin përkatës |       |      |
| 20 | Kullotja pa leje në fondin pyjor, pa dëmtuar bimësinë pyjore                                                                                                     | krerë |      |
|    | për gjedhet                                                                                                                                                      | krerë | 2700 |
|    | për të leshtat                                                                                                                                                   | krerë | 1350 |
|    | për të dhirtat                                                                                                                                                   | krerë | 1800 |
|    | për derrat                                                                                                                                                       | krerë | 2200 |
|    | për shpendët                                                                                                                                                     | krerë | 450  |
|    | për njëthundrakët                                                                                                                                                | krerë | 2200 |
| 21 | Kositja dhe grumbullimi pa leje në fondin pyjor të barit, gjetheve, kraneve e të tjera të kësaj natyre                                                           | kv    | 3500 |
| 22 | Vendosja e mullarëve të çfarëdo lloji e madhësie pa leje në fondin pyjor dhe jashtë vendeve të miratuara                                                         | copë  | 2700 |

**V E N D I M**  
**Nr.464, datë 3.7.2003**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.288, DATË 18.6.1999  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKËS  
SË ZHVILLIMIT TË TELEKOMUNIKACIONEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e disa ndryshimeve në dokumentin e politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.288, datë 18.6.1999 të Këshillit të Ministrave, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**NDRYSHIMET NË DOKUMENTIN “POLITIKA E ZHVILLIMIT TË  
TELEKOMUNIKACIONEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

1. Pika 4 “Privatizimi”, paragrafi i pestë, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Si kompensim të angazhimeve për investimet e përshkruara më sipër, Albtelecom-it do t’i jepet një e drejtë ekskluzive për të ofruar shërbime telefonike ndërkombëtare bazuar në rrjetin e tij për një periudhë deri më 31 dhjetor 2004.”.

2. Pika 5 “Liberalizimi”, iniciativa 4, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Shërbimet telefonike ndërkombëtare do të hapen për konkurrencë në vitin 2005.”.

3. Në tabelën e aneksit I “Klasifikimi i shërbimeve të telekomunikacioneve për qëllime licencimi”,

a) shfuqizohet përcaktimi “Vetëm Albtelecom (të paktën deri më 30.6.2003)” në rreshtin e dytë të klasës A “Shërbime telefonike kombëtare”, kolona e tretë “Komente mbi procedurat e licencimit”.

**V E N D I M**  
**Nr.465, datë 3.7.2003**

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI I  
MODERNIZIMIT TË AGJENCISË NACIONALE TË TRAFIKUT AJROR, SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1995 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Punonjësit, që mbeten të papunë nga procesi i modernizimit të Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror, sh.a., të trajtohen financiarisht, për një periudhë 2-vjeçare, duke filluar nga çasti i shkëputjes së marrëdhënieve të punës, në masën 100 për qind të pagës bazë mujore, shtesës së vjetërsisë në punë dhe sigurimet e detyrueshme.

2. Për këta punonjës kjo periudhë pagese të njihet si vjetërsi në punë për efekt pensioni dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.

3. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë punonjësit, që kanë qenë të punësuar në këtë shoqëri për një periudhë kohe jo më pak se një vit, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike, në formën e punësimit dhe të vetëpunësimit. Në rast të kundërt u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

4. Fondet financiare, të nevojshme për kryerjen e pagesës dhe për sigurimet e detyrueshme, të përballohen nga Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror, sh.a. Pagesa të bëhet nga zyrat e punësimit në rrethet përkatëse, duke bërë kalimin e fondeve të mësipërme në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

5. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**V E N D I M**  
**Nr.473, datë 10.7.2003**

**PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË FLAMURIT KOMBËTAR NË MJEDISËT E  
JASHTME DHE TË BRENDSHME, TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE, SI DHE RAPORTI I  
PËRMASAVE TË TIJ**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre” me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

## V E N D O S I:

1. Flamuri kombëtar, i ekspozuar në mjediset e jashtme dhe të brendshme, të institucioneve publike apo kur ai përdoret në veprimtari të ndryshme ose në ceremoni zyrtare, i shoqëruar ose jo me flamuj të tjerë, është kurdoherë i përmasave standarde 1x1.4 njësi, në përputhje me nenin 3 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002. Përmasat teknike të flamurit kombëtar, përmasat e shqiponjës, si dhe raportet e vendosjes së saj në fushën e flamurit janë dhënë në figurën 1 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë e tij.

2. Përmasat e flamurit kombëtar në mjediset e jashtme dhe të brendshme, të institucioneve publike, si dhe në sheshet kryesore të qyteteve janë të ndryshueshme, në varësi të vendit të ekspozimit, të lartësisë së shtizës dhe të shkallës hierarkike të institucionit. Këto përmasa janë si më poshtë vijon:

a) Për institucionet qendrore dhe përfaqësitë diplomatike, të akredituara jashtë vendit, si dhe kur flamujt vendosen në sheshet kryesore të qendrave të urbanizuara jo më pak se 1.50x2.10 metra.

b) Për institucionet e tjera publike jo më pak se 1.07x1.50 metra.

c) Kur përdoret në mënyrë të lirë, në tryezat e punës së punonjësve të institucioneve shtetërore, flamuri është i përmasave 16x23 cm.

ç) Kur përdoret në autoveturat e përfaqësive diplomatike të Shqipërisë në vende të tjera, ai është i përmasave 25x35 cm dhe vendoset në anën e djathtë të pjesës së përparme të autoveturës.

3. Kur flamuri kombëtar është i shoqëruar me një ose më shumë flamuj të vendeve të tjera, të organeve, organizatave ose shoqatave të çdo lloji, përmasat e tij fizike nuk do të jenë, në asnjë rast, më të vogla se të flamujve bashkëshoqërues, duke ruajtur gjithnjë raportet 1x1.4 njësi.

4. Institucionet publike, të cilat përdorin në mënyrë të detyruar flamurin kombëtar, kujdesen që flamujt e ekspozuar në mjediset e tyre të ripërtërihen, kur mbi ngjyrat kanë vepruar faktorë atmosferikë ose ata janë të dëmtuar, si dhe marrin masa për ndriçimin e tyre gjatë orëve të natës. Flamujt e vënë në sheshet kryesore të qendrave urbane janë nën kujdesin e administratave përkatëse të njësive të zgjedhura vendore.

5. Në ceremonitë protokollare dhe në solemnitete të tjera, të parashikuara me ligj, kur flamuri kombëtar shoqërohet me një ose disa flamuj të vendeve të tjera ose të organizmave politike e ushtarake, ndërkombëtare, çdo flamur tjetër do të vendoset në të majtë të tij. Rregulla më të hollësishme të përdorimit të flamurit në këto raste parashikohen në ceremonialin e Protokollit të Shtetit.

6. Gjatë zhvillimit të veprimtarive publike të institucioneve shtetërore me organe, organizata ose shoqata të tjera, brenda dhe jashtë vendit, dhe kur në këto raste përdoren simbolet ose flamujt e tyre përkatës, ata do të vendosen gjithnjë në të majtë të flamurit kombëtar, dhe në mënyrë që flamuri kombëtar të jetë më i evidentuar.

7. Në njësitë ushtarake, në institucionet e Rendit Publik dhe në Gardën e Republikës përdorimi i flamurit kombëtar bashkë me flamujt luftarakë të njësive apo çdo flamur tjetër, bëhet në përputhje me pikat 4 dhe 5 të këtij vendimi. Përdorimi i flamurit kombëtar në këto institucione në raste ceremonish, paradash, brenda dhe jashtë territoreve të reparteve, bëhet në përputhje me rregulloret ushtarake dhe, sipas rastit, në përputhje edhe me praktikat standarde të ceremonialit shtetëror.

8. Mënyra e përdorimit të flamurit kombëtar në mjediset e shkollave të të gjitha kategorive e niveleve është e njëjtë me përdorimin e tij në institucionet publike. Brenda vitit mësimor, në ditën e parë të çdo jave, nxënësit, së bashku me trupën mësimore, rreshtohen pranë flamurit kombëtar, ceremoni kjo që shoqërohet me ekzekutimin e himnit kombëtar. Në rastet kur kjo nuk mund të zbatohet, atëherë ekzekutimi i himnit kombëtar bëhet në mjedise të mbyllura, në çdo klasë.


9. Në festat me karakter kombëtar ose vendor, në festat zyrtare dhe në ditët përkujtimore, si dhe në manifestime të tjera, kulturore e sportive, krahas përdorimit zyrtar, flamuri kombëtar mund të përdoret edhe në funksione dekorative. Në këto raste raportet e përmasave të tij mund të jenë të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikat e mësipërme dhe flamuri mund të vendoset edhe vertikalisht, siç paraqitet në figurën 2, por në çdo rast shqiponja vendoset me kokën lart.

10. Ngarkohen administratat e të gjitha organeve dhe institucioneve publike dhe subjektet e licencuara për prodhimin e flamujve, në përputhje me standardet ligjore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Fatos Nano**

**Flamur festiv**



**Fig. 2**

**V E N D I M**  
**Nr.474, datë 10.7.2003**

## **PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË STEMËS SË REPUBLIKËS, SI DHE RAPORTIN E PËRMASAVE TË SAJ**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 8 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, për mbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, me propozimin e Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

### **V E N D O S I:**

1. Stema e Republikës, kudo që ajo përdoret, në emërtimet e institucioneve shtetërore, në aktet zyrtare që ato lëshojnë, në kartat e identitetit të shtetasve apo në çdo dokument tjetër paraqitet me pamje standarde, në përmasat dhe të gjitha elementet përbërëse të saj, në përputhje me kërkesat e pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002. Pamja e stemës së Republikës dhe raportet e përmasave të secilit element të stemës janë dhënë në figurën 1 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë e tij.

2. Kur stema e Republikës shërben si emërtim në hyrje të institucioneve, përdoret tabela standarde në përmasat 500x700 mm, me vendosje horizontale. Fusha e tabelës të jetë me ngjyrë të artë, ndërsa shkrimi me ngjyrë të zezë. Në pjesën e sipërme të tabelës shkruhet me shkronja kapitale “Republika e Shqipërisë” dhe, nëse ka, në rreshtat e tjera shënohen strukturat vartëse në linjë vertikale. Në qendër të tabelës vendoset stema e Republikës, me përmasa 100x150 mm, ndërsa poshtë saj, gjithashtu me shkronja kapitale, vihet emërtimi i institucionit, sipas modeleve të dhëna në figurën 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Përskrimi gjeometrik i vulave, ku përdoret stema e Republikës nga institucionet shtetërore, është si më poshtë vijon:

a) Diametri i vulës së njomë, të thatë ose prej dylli është standard 40 mm. Përjashtim bëjnë vulat e sekretarive të institucioneve qendrore, që mund të jenë me diametër më të vogël dhe vulat e thata të noterëve, që, për arsye teknike, janë më të mëdha nga standardi i mësipërm.

b) Stema e Republikës vihet kurdoherë në qendër të vulës, me përmasa të ndryshueshme, në varësi të të dhënave që përmban vula.

c) Në rrethin e jashtëm, në krye të vulës shënohen fjalët “Republika e Shqipërisë” dhe më pas vijon renditja administrative hierarkike, deri tek institucioni në fjalë dhe vendndodhja e selisë së tij. Shkronjat e vulës janë kapitale, me madhësi të ndryshueshme, por kurdoherë të dukshme, siç janë paraqitur në figurën 3 të shtojcës.

4. Stema e Republikës, kur përdoret në aktet zyrtare shkresore, vendoset në krye të fletës format A4, në përmasat 10/15 mm, ndërsa poshtë saj shkruhet me shkronja kapitale “Republika e Shqipërisë” dhe në rreshtat e mëposhtëm, institucionet përkatëse. Në rastet kur stema e Republikës nuk është me ngjyrë, atëherë përdoret stema me konture bardhezi, por jo duke u fotokopjuar stema me ngjyrë bardhezi. Përdorimi i stemës me ngjyrë dhe asaj bardhezi do të bëhen sipas modeleve “a” dhe “b”, të figurës 4 të shtojcës. Stema e Republikës vihet në vend të dukshëm edhe në certifikatat e identifikimit të shtetasve, në dëftesa ose diploma shkollore, në shpallje publike me karakter zyrtar të organeve shtetërore, në licenca etj.

5. Institucionet shtetërore, të niveleve të ndryshme, kur është fjala për komunikimet jozyrtare me të tretë, mund të përdorin edhe logot e tyre në botime të ndryshme, në reklama etj.

6. Ngarkohen administratat e të gjitha organeve dhe të institucioneve shtetërore dhe subjektet e licencuara për prodhimin e vulave ose të botimeve, që i përmbajnë këto vula, për zbatimin e këtij vendimi.

7. Afatet e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këtë vendim janë deri në tre muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

1.5

0.028

0.05

0.224

0.30

0.32

0.05

0.028



1

0.028

0.075

0.25

0.06

0.9

0.137

0.05



## Vulat Zyrtare



## Vulë e Thatë

Fig.3



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E RENDIT PUBLIK  
DREJTORIA E POLICISE QARKUT TIRANE

Nr.....Prot.

Tiranë.....

---

Fig.4/a



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E RENDIT PUBLIK  
DREJTORIA E POLICISE QARKUT TIRANE

Nr.....Prot.

Tiranë.....

---

Fig.4/b

**V E N D I M**  
**Nr.475, datë 10.7.2003**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KARAKTERISTIKAT E VAJRAVE TË ULLIRIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8944, datë 19.2.2002 “Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Miratimin e rregullore “Për karakteristikat e vajrave të ullirit”, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**RREGULLORE**  
**“PËR KARAKTERISTIKAT E VAJRAVE TË ULLIRIT”**

**KREU I**  
**Neni 1**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i karakteristikave të cilësisë dhe kriterëve të natyrshmërisë së vajrave të ullirit të përkufizuar në nenin 2 të ligjit nr.8944, datë 19.9.2002 “Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajrave të ullirit”.

**Neni 2**

Kjo rregullore do të zbatohet për vajrat e ullirit, karakteristikat shijore dhe cilësore të të cilave përputhen me përcaktimet e bëra në nenin 2 të ligjit.

**Neni 3**

Vajrat e ullirit sipas karakteristikave klasifikohen:

1. Vaj ulliri i virgjër i cili ndahet:
  - vaj ulliri i virgjër i cilësisë së lartë
  - vaj ulliri i virgjër
  - vaj ulliri i virgjër i zakonshëm
  - vaj ulliri i virgjër ndriçues
2. Vaj ulliri i rafinuar
3. Vaj ulliri
4. Vaj ulliri i bërsisë së papërpunuar
5. Vaj i bërsisë së ullirit, i rafinuar
6. Vaj i bërsisë së ullirit

**KREU II**  
**PËRKUFIZIMET, KARAKTERISTIKAT CILËSORE DHE KRITERET E NATYRSHMËRISË SË**

## VAJRAVE TË ULLIRIT

### Neni 4

Vaj ulliri i virgjër i cilësisë së lartë:

Është vaji i ullirit, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 1 g për 100 g vaj.

1. Karakteristikat cilësore:

1.1 Treguesit organo-shqisorë

- Ngjyra: Vaj i qartë, me ngjyrë të verdhë në jeshile

- Era: Karakteristike e frutit të freskët të ullirit

- Shija: Pikante e frutit të freskët të ullirit

1.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Aciditeti i lirë jo më shumë se 1.0 %

- Vlera e peroksideve jo më shumë se 20 mek O<sub>2</sub>/kg

- Koeficienti i përthithjes ultraviolet (UV)K<sub>232</sub> jo më shumë se 2.40

K<sub>270</sub> jo më shumë se 0.20

Delta K jo më shumë se 0.01

2. Kriteret e natyrshmërisë:

2.1 Përbërja e acideve yndyrore në %, e përcaktuar me gazkromatografi, është si më poshtë:

- Acid miristik jo më shumë se 0.1

- Acid palmitik 7.5-20.0

- Acid palmitoleik 0.3-3.5

- Acid stearik 0.5-5.0

- Acid oleik 55.0-83.0

- Acid linoleik 3.5-21.0

- Acid linolenik jo më shumë se 1.5

- Acid arahidik jo më shumë se 0.8

2.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Dendësia relative (200 C/ujë në 20°C) 0.910-0.916

- Indeksi i refraksionit (n<sub>20 D</sub>) 1.4677-1.4705

- Numri i sapunifikimit (mg KOH/g vaj) 184-196

- Numri i jodit (Wijs) 75-94

- Lëndë të pasapapunifikueshme (me eterpetrol) jo më shumë se 15 g/kg

3. Ndotësit

- Lëndët flurore në 1050 celcius ≤ 0.2% m/m

- Papastërtitë e patretshme ≤ 0.1% m/m

- Testi i sapunit negativ

### Neni 5

Vaj ulliri i virgjër:

Është vaji i ullirit në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 2g për 100 g vaj.

1. Karakteristikat cilësore:

1.1 Treguesit organo-shqisorë

- Ngjyra: Vaj i qartë, me ngjyrë të verdhë në jeshile

- Era: Karakteristike e frutit të ullirit

- Shija: Karakteristike e frutit të ullirit

1.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Aciditeti jo më shumë se 2.0%

- Vlera e peroksideve jo më shumë se 20 mek O<sub>2</sub>/kg

- Koeficienti i përthithjes ultraviolet (UV)K<sub>232</sub> jo më shumë se 2.60

(UV)K270 jo më shumë se 0.25

Delta K jo më shumë se 01

2. Kriteret e natyrshmërisë:

2.1 Përbërja e acideve yndyrore në 0%, e përcaktuar me gazkromatografi, është si më poshtë:

- Acid miristikjo më shumë se 0.1

- Acid palmitik 7.5-20.0

- Acid palmitoleik 0.3-3.5

- Acid stearik 0.5-5.0

- Acid oleik 55.0-83.0

- Acid linoleik 3.5-21.0

- Acid linolenikjo më shumë se 1.5

- Acid arahidikjo më shumë se 0.8

2.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Dendësia relative (200 C/ujë në 200C) 0.910-0.916

- Indeksi i refraksionit (n<sub>20 D</sub>) 1.4677-1.4705

- Numri i sapunifikimit (mg KOH/g vaj) 184-196

- Numri i jodit (Wijs) 75-94

- Lëndë të pasapunifikueshme (në eterpetrol) jo më shumë se 15 g/kg

3. Ndotësit

- Lëndët fluore në 1050 celcius ≤ 0.2% m/m

- Papastërtitë e patretshme ≤ 0.1% m/m

- Testi i sapuniti papërfillshëm

#### Neni 6

Vaj ulliri i virgjër i zakonshëm:

Është vaj i ullirit i virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 3.3 g për 100 g vaj.

1. Karakteristikat cilësore:

1.1 Treguesit organo-shqisore

- Ngjyra: Vaj i qartë, me ngjyrë të verdhë në jeshile të çelët

- Era: E lehtë e frutit të ullirit.

- Shija: E frutit të ullirit

1.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Aciditeti jo më shumë se 2.0%

- Vlera e peroksideve jo më shumë se 20 mek O<sub>2</sub>/kg

- Koeficienti i përthithjes ultraviolett (UV)K232 jo më shumë se 2.60

K270 jo më shumë se 0.25

Delta K jo më shumë se 0.01

2. Kriteret e natyrshmërisë:

2.1 Përbërja e acideve yndyrore në %, e përcaktuar me gazkromatografi, është si më poshtë:

- Acid miristikjo më shumë se 0.1

- Acid palmitik 7.5-20.0

- Acid pamitoleik 0.3-3.5

- Acid stearik 0.5-5.0

- Acid oleik 55.0-83.0

- Acid linoleik 3.5-21.0

- Acid linolenikjo më shumë se 1.5

- Acid arahidikjo më shumë se 0.8

2.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Densiteti relativ (20o C/ujë në 20o C) 0.910-0.916

- Indeksi i refraksionit (n<sub>20 D</sub>) 1.4677-1.4705

- Numri i sapunifikimit (mg KOH/g vaj) 184-196

- Numri i jodit (Wijs) 75-94
- Lëndë të pasapunifikueshme (me eterpetrol) jo më shumë se 15 g/kg
- 3. Ndotësit
  - Lëndët flurore në 1050 celcius  $\leq 0.2\%$  m/m
  - Papastërtitë e patretshme  $\leq 0.1\%$  m/m
  - Testi i sapunitnegativ

#### Neni 7

Vaj ulliri i virgjër ndriçues:

Është vaji i ullirit i virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik është më shumë se 3.3 g për 100 g vaj. Ky vaj nuk lejohet për konsum njerëzor.

1. Karakteristikat cilësore:

1.1 Treguesit organo-shqisore

- Ngjyra: E verdhë, e errët
- Era: Aromë dhe shije e papranueshme për konsum njerëzor

1.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Aciditeti:  $>3.3\%$
- Vlera e peroksideve më shumë se 20 mek O<sub>2</sub>/kg
- Koeficienti i përthithjes ultraviolet (UV)K<sub>232</sub> jo më shumë se 3.70
- K<sub>270</sub> $>0.25$

Delta K-nuk kapet

2. Kriteret e natyrshmërisë:

2.1 Përbërja e acideve yndyrore në %, e përcaktuar me gazkromatografi, është si më poshtë:

- Acid miristikjo më shumë se 0.1
- Acid palmitik 7.5-20.0
- Acid palmitoleik 0.3-3.5
- Acid stearik 0.5-5.0
- Acid oleik 55.0-83.0
- Acid linoleik 3.5-21.0
- Acid linolenikjo më shumë se 1.5
- Acid arahidikjo më shumë se 0.8

2.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Dendësia relative (200 C/ujë në 200 C) 0.910-0.916
- Indeksi i refraksionit (n<sub>20 D</sub>) 1.4677-1.4705
- Numri i sapunifikimit (mg KOH/g vaj) 184-196
- Numri i jodit (Wijs) 75-94
- Lëndë të pasapunifikueshme (me eterpetrol) jo më shumë se 15 g/kg

3. Ndotësit

- Lëndët flurore në 1050 celcius  $\leq 0.2\%$  m/m
- Papastërtitë e patretshme  $\leq 0.1\%$  m/m
- Testi i sapunitnegativ

#### Neni 8

Vaj ulliri i rafinuar:

Është vaj i ullirit i përfituar nga rafinimi i vajit të ullirit të virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 0.5 g për 100 g vaj.

1. Karakteristikat cilësore:

1.1 Treguesit organo-shqisore

- Ngjyra: E verdhë ose e verdhë në jeshile, vaj i qartë, i rrjedhshëm pa fundërri
- Shija: Pa shije specifike

2.1 Treguesit fiziko-kimikë

- Aciditeti i lirë jo më shumë se 0.5%
- Vlera e peroksideve: jo më shumë se 10 mek O<sub>2</sub>/kg vaj

- Koeficienti i përthithjes ultraviolet (UV)

K232 jo më shumë se 3.40

K270 jo më shumë se 1.20

Delta K jo më shumë se 0.16

2. Kriteret e natyrshmërisë:

2.1 Përbërja e acideve yndyrore në %, e përcaktuar me gazkromatografi, është si më poshtë:

- Acid miristik jo më shumë se 0.1

- Acid palmitik 7.5-20.0

- Acid palmitoleik 0.3-3.5

- Acid stearik 0.5-5.0

- Acid oleik 55.0-83.0

- Acid linoleik 3.5-21.0

- Acid linolenik jo më shumë se 1.5

- Acid arahidik jo më shumë se 0.8

2.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Dendësi relative (20°C/ujë në 20°C) 0.910-0.916

- Indeksi i refraksionit (n<sub>20 D</sub>) 1.4680-1.4707

- Numri i sapunifikimit (mg KOH/g vaj) 184-196

- Numri i jodit (Wijs) 75-94

- Lëndë të pasapapunifikueshme (në eterpetrol) jo më shumë se 15 g/kg

3. Ndotësit

- Lëndët fluore në 1050 celcius ≤ 0.1% m/m

- Papastërtitë e patretshme ≤ 0.05% m/m

- Testi i sapunit negativ

## Neni 9

Vaj ulliri:

Është vaji i ullirit i përftuar nga një përzierje e vajit të ullirit të rafinuar dhe të vajit të ullirit të virgjër, pa vajin e ullirit të virgjër ndriçues, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 1.5 g për 100 g vaj.

1. Karakteristikat cilësore:

1.1 Treguesit organo-shqisorë

- Ngjyra: E verdhë, në jeshile të lehtë

- Era dhe shija: E lehtë e frutit të ullirit

1.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Aciditeti jo më shumë se 1.5%

- Vlera e peroksideve jo më shumë se 15 mek O<sub>2</sub>/kg

- Koeficienti i përthithjes specifike ultraviolet (UV) K232 jo më shumë se 3.40

K270 jo më shumë se 1.00

Delta K jo më shumë se 0.13

2. Kriteret e natyrshmërisë:

2.1 Përbërja e acideve yndyrore në %, e përcaktuar me gazkromatografi, është si më poshtë:

- Acid miristik jo më shumë se 0.1

- Acid palmitik 7.5-20.0

- Acid palmitolik 0.3-3.5

- Acid stearik 0.5-5.0

- Acid oleik 55.0-83.0

- Acid linoleik 3.5-21.0

- Acid linolenik jo më shumë se 1.5

- Acid arahidik jo më shumë se 0.8

2.2 Treguesit fiziko-kimikë të origjinës:

- Densiteti relativ (20o C/ujë në 20o C) 0.910-0.916
- Indeksi i refraksionit (n<sub>20 D</sub>) 1.4677-1.4705
- Numri i sapunifikimit (mg KOH/g vaj) 184-196
- Numri i jodit (Wijs) 75-94
- Lëndë të pasapapunifikueshme (me eterpetrol) jo më shumë se 15 g/kg.

### 3. Ndotësit

- Lëndët flurore në 105o celcius ≤ 0.1% m/m
- Papastërtitë e patretshme ≤ 0.05% m/m
- Testi i sapuniti papërfillshëm

## Neni 10

Vaji i bërsisë së ullirit i papërpunuar:

Është vaj i ullirit i përfituar nga trajtimi me tretës i bërsisë së ullirit, i cili nuk përmban vajra të përfituara nga proceset e riesterifikimit ose çdo lloj përzjerjeje me vajra me natyrë tjetër nga ai i ullirit. Ky vaj nuk lejohet për konsum njerëzor.

### 1. Karakteristikat cilësore:

#### 1.1 Treguesit organo-shqisorë

- Ngjyra: E verdhë e errët
- Era: E papranueshme
- Shija: E papranueshme

#### 1.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Aciditeti: minimumi 2%
- Vlera e peroksideve: -
- Koeficienti i përthithjes ultraviolet (UV) – i papërfillshëm

### 2. Kriteret e natyrshmërisë:

2.1 Përbërja e acideve yndyrore në %, e përcaktuar me gazkromatografi, është si më poshtë:

- Acid miristikjo më shumë se 0.1
- Acid palmitik 7.5-20.0
- Acid palmitoleik 0.3-3.5
- Acid stearik 0.5-5.0
- Acid oleik 55.0-83.0
- Acid linoleik 3.5-21.0
- Acid linolenikjo më shumë se 1.5
- Acid arahidikjo më shumë se 0.8

## Neni 11

Vaj i bërsisë së ullirit i rafinuar:

Është vaji i përftuar nga rafinimi i vajit të bërsive të ullirit, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 0.5 g për 100 g vaj.

### 1. Karakteristikat cilësore:

#### 1.1 Treguesit organo-shqisorë

- Ngjyra: E verdhë ose e verdhë në kafe
- Era: Pa erë specifike
- Shija: Pa shije specifike

#### 1.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Aciditeti jo më shumë se 0.5%
- Vlera e peroksideve jo më shumë se 10 mek O<sub>2</sub>/kg
- Koeficienti i përthithjes specifike ultraviolet (UV) K<sub>232</sub> jo më shumë se 5.50
- K<sub>270</sub> jo më shumë se 2.50
- Delta K jo më shumë se 0.25

### 2. Kriteret e natyrshmërisë:

2.1 Përbërja e acideve yndyrore në %, e përcaktuar me gazkromatografi, është si më poshtë:

- Acid miristikjo më shumë se 0.1

- Acid palmitik 7.5-20.0
- Acid palmitoleik 0.3-3.5
- Acid stearik 0.5-5.0
- Acid oleik 55.0-83.0
- Acid linoleik 3.5-21.0
- Acid linolenik jo më shumë se 1.5
- Acid arahidik jo më shumë se 0.8
- 2.2 Karakteristikat fiziko-kimike
- Dendësia relative (20o C/ujë në 20o C) 0.910-0.916
- Indeksi i refraksionit (n<sub>20 D</sub>) 1.4680-1.4707
- Numri i sapunifikimit (mg KOH/g vaj) 182-193
- Numri i jodit (Wijs) 75-92
- Lëndë të pasapapunifikueshme (me eterpetrol) jo më shumë se 30 g/kg
- 3. Ndotësit
- Lëndët flurore në 105o celcius ≤ 0.1% m/m
- Papastërtitë e patretshme ≤ 0.1% m/m
- Testi i sapunit negativ

## Neni 12

Vaj i bërshisë së ullirit:

Është vaji i përfutur nga një përzierje e vajit të bërshisë së ullirit të rafinuar dhe të vajrave të ullirit të virgjëra pa vajin e virgjër ndriçues, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 1.5 g për 100 g vaj.

1. Karakteristikat cilësore:

1.1 Treguesit organo-shqisorë

- Ngjyra: E verdhë e theksuar, e qartë
- Era: Me erë të lehtë karakteristike të ullirit
- Shija: Me shije të lehtë karakteristike të ullirit

1.2 Treguesit fiziko-kimikë

- Aciditeti jo më shumë se 1.5%
- Vlera e peroksideve jo më shumë se 15 mek O<sub>2</sub> aktiv/kg

- Koeficienti i përthithjes ultraviolett (UV) specifike K<sub>232</sub> jo më shumë se 5.50

K<sub>270</sub> jo më shumë se 2.00

Delta K jo më shumë se 0.20

2. Kriteret e natyrshmërisë:

2.1 Përbërja e acideve yndyrore në %, e përcaktuar me gazkromatografi, është si më poshtë:

- Acid miristik jo më shumë se 0.1

- Acid palmitik 7.5-20.0

- Acid palmitoleik 0.3-3.5

- Acid stearik 0.5-5.0

- Acid oleik 55.0-83.0

- Acid linoleik 3.5-21.0

- Acid linolenik jo më shumë se 1.5

- Acid arahidik jo më shumë se 0.8

2.2 Karakteristikat fiziko-kimike

- Dendësia relative (20o C/ujë në 20o C) 0.910-0.916

- Indeksi i refraksionit (n<sub>20 D</sub>) 1.4677-1.4705

- Numri i sapunifikimit (mg KOH/g vaj) 184-196

- Numri i jodit (Wijs) 75-94

- Lëndë të pasapapunifikueshme (me eterpetrol) jo më shumë se 15 g/kg

3. Ndotësit

- Lëndët flurore në 105o celcius ≤ 0.1% m/m

- Papastërtitë e patretshme  $\leq 0.05\%$  m/m
- Testi i sapunit nuk aplikohet

### KREU III NENI 13

#### Metodat e përdorura

1. Për përcaktimin e karakteristikave cilësore dhe kriterëve të natyrshmërisë përdoren metodat:
  - SSH (Standard Shqiptar)
  - ISO (Standard Ndërkombëtar)
  - EN (Standard European)
2. Për përcaktimin e treguesve organo-shqisore të vajrave të ullirit të pranishme në tregun shqiptar të përdoret metoda e PANEL-TEST-it.

#### Neni 14

1. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të përcaktojë Komisionin e Ekspertëve të vlerësimit organo-shqisore të vajrave të ullirit.
2. Procedurat për funksionimin e Komisionit të përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

#### Neni 15

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## V E N D I M Nr.477, datë 10.7.2003

### **PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR VORË-MAMINAS, PJESË E SUPERSTRADËS TIRANË-DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Vorë-Maminas, pjesë e superstradës Tiranë-Durrës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 11 527 m<sup>2</sup> tokë/arë dhe 184 432 lekë kultura bujqësore, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 21 163 572 (njëzet e një milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 373 000 (treqind e shtatëdhjetë e tre mijë) lekësh.
5. Fondi prej 21 536 572 (njëzet e një milionë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh, për kompensimin e pronarëve dhe për shpenzimet procedurale, të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të

Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.7.2003.
  7. Pagesat të bëhen sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”.
  8. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Fatos Nano**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QARKU: TIRANË  
BASHKIA: VORË

LISTA E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR VORË-MAMINAS PJESË E  
SUPERSTRADËS TIRANË-DURRËS

Lloji i pasurisë së palutajshme tokë bujqësore nr. (1-33)

|     | Pronar  |         |                | Nr.<br>Pass | Tokë are |        |            | Kulturë bujqësore |                | Vlera<br>lekë | Shënime            |
|-----|---------|---------|----------------|-------------|----------|--------|------------|-------------------|----------------|---------------|--------------------|
| Nr. | Emri    | Atësia  | Mbiemri        |             | Sip/m2   | Lek m2 | Vlera/lekë | Lek/m2            | Vlera/l<br>ekë |               |                    |
| 1   | Bashkim | Adem    | Muça           | 89/36       | 264      | 1820   | 480480     | 16                | 4 224          | 484 704       | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 2   | Arbeta  | Besim   | Rushku         | 89/42       | 150      | 1820   | 273000     | 16                | 2 400          | 275 400       | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 3   | Ilir    | Seit    | Muça           | 89          | 52       | 1820   | 94640      | 16                | 832            | 95 472        | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 4   | Skënder | Hatem   | Mukaj          | 89/67       | 332      | 1820   | 604240     | 16                | 5 312          | 609 552       | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 5   | Arben   | Mexhit  | Karamuça       | 89/50       | 95       | 1820   | 172900     | 16                | 1 520          | 174 420       | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 6   | Fatmir  | Elez    | Muça           | 89/88       | 1520     | 1820   | 2766400    | 16                | 24 320         | 2 790 720     | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 7   | Fisnik  | Elez    | Muça           | 89/12       | 1520     | 1820   | 2766400    | 16                | 24 320         | 2 790 720     | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 8   | Mid'hat |         | Almanzala<br>o | 102/10      | 2710     | 1820   | 4932200    | 16                | 43 360         | 4 975 560     | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 9   | Bajram  | Dalip   | Maloku         | 102         | 500      | 1820   | 910000     | 16                | 8 000          | 918 000       | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 10  | Tushe   | Hider   | Gjoka          | 102/6       | 420      | 1820   | 764400     | 16                | 6 720          | 771 120       | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 11  | Riza    | Vath    | Gjoka          | 102/5       | 280      | 1820   | 509600     | 16                | 4 480          | 514 080       | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 12  | Hider   | Rrahman | Gjoka          | 102         | 525      | 1820   | 955500     | 16                | 8 400          | 963 900       | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 13  | A.K.U.S |         | Group          | 89/74       | 399      | 1820   | 726180     | 16                | 6 384          | 732 564       | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 14  | Rudina  | Shefki  | Karalliu       | 39/13       | 393      | 1820   | 715260     | 16                | 6 288          | 721 548       |                    |
| 15  | Rudina  | Shefki  | Karalliu       | 39/9        | 525      | 1820   | 955500     | 16                | 8 400          | 963 900       |                    |
| 16  | Rudina  | Shefki  | Karalliu       | 39/15       | 52       | 1820   | 94640      | 16                | 832            | 95 472        |                    |
| 17  | Veli    | Mehdi   | Rrapi          | 39/26       | 10       | 1820   | 18200      | 16                | 160            | 18 360        | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 18  | Aishe   | Osman   | Picari         | 29          | 242      | 1820   | 440440     | 16                | 3 872          | 444 312       | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 19  | Sali    | Haxhi   | Picari         | 30          | 119      | 1820   | 216580     | 16                | 1 904          | 218 484       | Konfirmim Z.Rr.P.P |

|    |                  |          |        |       |        |      |            |    |         |            |                    |
|----|------------------|----------|--------|-------|--------|------|------------|----|---------|------------|--------------------|
| 20 | Jakup            | Haxhi    | Picari | 30    | 183    | 1820 | 333060     | 16 | 2 928   | 335 988    | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 21 | Arif             | Murat    | Mukaj  | 25    | 210    | 1820 | 382200     | 16 | 3 360   | 385 560    | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 22 | Reshit           | Selman   | Mariku | 83/12 | 20     | 1820 | 36400      | 16 | 320     | 36 720     | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 23 | Gëzim            | Emin     | Mariku | 83/13 | 171    | 1820 | 311220     | 16 | 2 736   | 313 956    | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 24 | Xhevdet          | Avdullah | Bylyku | 83/21 | 20     | 1820 | 36400      | 16 | 320     | 36 720     | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 25 | Avdullah         | Shaban   | Bylyku | 83/22 | 25     | 1820 | 45500      | 16 | 400     | 45 900     | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 26 | Mehmet           | Hasan    | Bylyku | 269/2 | 91     | 1820 | 165620     | 16 | 1 456   | 167 076    | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 27 | Asllan           | Hasan    | Bylyku | 269/4 | 73     | 1820 | 132860     | 16 | 1 168   | 134 028    | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 28 | Sherif           | Besim    | Bylyku | 269/3 | 91     | 1820 | 165620     | 16 | 1 456   | 167 076    | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 29 | I paidentifikuar |          |        | 39/27 | 35     | 1820 | 63700      | 16 | 560     | 64 260     | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 30 | I paidentifikuar |          |        | 39/19 | 113    | 1820 | 205660     | 16 | 1 808   | 207 468    | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 31 | I paidentifikuar |          |        | 39/8  | 72     | 1820 | 131040     | 16 | 1 152   | 132 192    | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 32 | I paidentifikuar |          |        | 39/12 | 120    | 1820 | 218400     | 16 | 1 920   | 220 320    | Konfirmim Z.Rr.P.P |
| 33 | I paidentifikuar |          |        | 39/16 | 195    | 1820 | 354900     | 16 | 3 120   | 358 020    | Konfirmim Z.Rr.P.P |
|    | Shuma            |          |        |       | 11 527 | 1820 | 20 979 140 | 16 | 18443 2 | 21 163 572 |                    |

**V E N D I M**  
**Nr.21, datë 10.7.2003**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese  
Zija Vuci Anëtar i ““  
Gjergj Sauli Anëtar i ““  
Kristofor Peçi Anëtar i ““  
Kujtim Puto Anëtar i ““  
Xhezair Zaganjori Anëtar i ““  
Petrît Plloçi Anëtar i ““  
Sokol Sadushi Anëtar i ““  
Alfred Karamuço Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 30.5.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.26 Akti që i përket:

KËRKUES: Ilirjan Arapi, përfaqësuar nga avokati Neshat Fana, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga prokurori Skënder Breca, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.39, datë 24.4.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr.237, datë 24.9.2002 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.3, datë 8.1.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të sipërme:

- I është nënshtruar një procesi të paligjshëm, sepse ndaj tij nuk kishte një akuzë të ngritur ligjërisht. Ndaj tij është pushuar çështja penale nga prokurori i rrethit Kavajë dhe këtë vendim nuk mund ta shfuqizojë një prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

- Akuza ndaj tij është mbështetur kryesisht në thëniet e një dëshmitareje, e cila për këto thënie është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kallëzim të rremë.

**GJYKATA KUSHTETUTESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

Me vendimin nr.39, datë 24.4.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, kërkuesi Ilirjan Arapi është deklaruar fajtor për veprat penale të vrasjes së kryer me paramendim dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe është dënuar me 16 vjet burg. Këtë vendim e ka lënë në fuqi Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.237, datë 24.9.2002. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr.3, datë 8.1.2003 ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.

Me kërkesën e paraqitur, si dhe në parashtrimin që bëri para gjykatës përfaqësuesi i kërkuesit, është pretenduar se vendimet gjyqësore të lartpërmendura janë rezultat i procesit të parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë e për këtë arsye, ato duhet të shfuqizohen si antikushtetuese.

Gjykata Kushtetuese ka arritur në konkluzionin se ky pretendim është i pabazuar, për pasojë kërkesa duhet të rrëzohet.

1. Prokurori i rrethit Kavajë, në datën 20.3.2000, ka vendosur pushimin e çështjes penale

nr.58, në ngarkim të Ilirjan Arapit, për mungesë provash. Ky vendim del të jetë shfuqizuar me vendimin e datës 25.7.2000 nga një prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Hetimet kanë vazhduar dhe përfundimisht çështja ka shkuar për shqyrtim gjyqësor, nga ku Ilirjan Arapi është deklaruar fajtor dhe është dënuar.

Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i marrë nga prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme ka qenë i paligjshëm, për arsye se në bazë të nenit 24 pika 5 të Kodit të Procedurës Penale, vendimet e prokurorit më të ulët mund t'i ndryshojë ose t'i shfuqizojë prokurori më i lartë dhe që në rastin konkret është Prokurori i Përgjithshëm. Për pasojë, sipas pretendimit të kërkuesit, të gjitha veprimet e mëvonshme procedurale kanë qenë të pavlefshme, të marra në mënyrë të kundërligjshme e të ndaluara shprehimisht nga neni 32/2 i Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese nuk e gjen të kundërligjshëm interpretimin e ligjit të referuar nga kërkuesi, i cili është i konfirmuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, sipas të cilës, në raport me prokurorin e rrethit, prokurori më i lartë do të konsiderohet Prokurori i Përgjithshëm. Por, Gjykatës Kushtetuese nuk i rezulton në çështjen konkrete se vendimi i prokurorit të rrethit Kavajë, është shfuqizuar, duke u mënjeluar Prokurori i Përgjithshëm nga ushtrimi i kësaj kompetence. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, paraqiti gjatë gjykimit dokumentin me nr.698/1, datë 25.7.2000, nënshkruar nga Prokurori i Përgjithshëm, nga ku del e qartë se dosja hetimore në ngarkim të Ilirjan Arapit, së bashku me disa dosje të tjera ishin tërhequr në Prokurorinë e Përgjithshme me dijeninë e tij dhe se vendimi i pushimit ishte shfuqizuar po me dijeninë e tij. Nga dokumenti del qartë dijenia e vullneti i Prokurorit të Përgjithshëm, si prokurori më i lartë në ushtrimin e kompetencave të parashikuara nga neni 24 pika 5. Nuk është e drejtë e Gjykatës Kushtetuese, në rastin konkret, të përcaktojë se me çfarë mjetesh procedurale apo administrative duhe të pasqyronte vullnetin Prokurori i Përgjithshëm në ushtrim të kompetencave të tij.

2. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat në deklarinë e tij fajtor janë bazuar kryesisht në thëniet e dëshmitares Tatjana Meta, e cila për këto deklarime është dënuar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në bazë të nenit 305 të Kodit Penal.

Gjykata Kushtetuese ka tashmë një praktikë të konsoliduar lidhur me administrimin e vlerësimit e provave në një proces gjyqësor penal apo civil. Sipas saj, këto janë prerrogativa të gjykatave të zakonshme dhe ato në përgjithësi nuk përbëjnë objekt për kontroll kushtetues për proces të parregullt, me përjashtim të rasteve kur vërtetohet se provat janë marrë me mjete e mënyra antikushtetuese. Në këto kushte, pretendimi i mësipërm nuk përbën shkak që mund të ndikojë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

## V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

## MENDIMI I PAKICËS

Thelbin e kësaj çështjeje e përbën fakti nëse për shfuqizimin e akteve të prokurorit më të ulët nga Prokurori i Përgjithshëm mjafton vetëm shfaqja e vullnetit të këtij të fundit apo kërkohet edhe

veshja e këtij vullneti me një formë të caktuar ligjore. Për mendimin tim, kjo përbën një çështje të zgjidhur tashmë nga ligji, doktrina, por edhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë.

Për shfuqizimin e aktit juridik nga një organ më i lartë duhet të respektohet e njëjta formë që është ndjekur për hartimin e këtij akti. Ky është një rregull i njohur. Pavarësisht se në nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale, nuk është parashikuar në mënyrë të shprehur forma që duhet të ketë akti shfuqizues i prokurorit më të lartë, është vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilët duke bërë interpretimin e kësaj dispozite ligjore, kanë evituar edhe mendimet e dyzuara për këtë çështje.

Në këtë vendim unifikues arsyetohet ndërmjet të tjerave se prokurori më i lartë, në zbatim të kompetencave që i jep neni 24/4 që urdhrat dhe udhëzimet e tij janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët, disponon mbi aktet e këtij të fundit, gjë që bëhet me një akt procedural e nuk mund të pranohet se bëhet verbalisht. Në këtë aspekt, vendimi i prokurorit më të lartë, për shfuqizimin e një vendimi të marrë nga një prokuror tjetër për pushimin e çështjes penale, përbën në vetvete një urdhër në zbatim të nenit 24/4 të Kodit të Procedurës Penale.

Në vazhdim të kësaj logjike arsyetimi, të përdorur në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, mendoj se edhe referimi tek neni 125 i Kodit të Procedurave Administrative, është i domosdoshëm për të konkluduar mbi formën që duhet të ketë një akt shfuqizues i organit kompetent. Sipas këtij neni “me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe, akti revokues apo shfuqizues ka të njëjtën formë ligjore dhe ndjek të njëjtat procedura me aktin që revokohet ose shfuqizohet”.

Për rastin në shqyrtim, vendimi për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal në ngarkim të të pandehurit Ilirjan Arapi nuk është përpiluar dhe nënshkruar nga Prokurori i Përgjithshëm, por nga një prokuror në këtë institucion. Pikërisht mënyra e hartimit të këtij vendimi nga një person jo kompetent, përbën dhe thelbin e çështjes. Shumica e Gjykatës Kushtetuese argumenton në vendim qëndrimin e saj për rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se përderisa dosja në ngarkim të Ilirjan Arapit ishte tërhequr në institucionin e Prokurorit të Përgjithshëm me dijeninë e vetë titullarit, edhe vendimi i pushimit, pavarësisht se është hartuar nga një prokuror tjetër dhe jo nga Prokurori i Përgjithshëm, në fakt e përmban dijeninë e këtij të fundit.

Një arsyetim i tillë nuk përputhet me kuptimin që ka dispozita ligjore dhe me arsyetimin që Gjykata e Lartë i ka dhënë në mënyrë specifike dispozitës konkrete. Shkresa përcjellëse nr.698/1, datë 25.7.2000, nënshkruar nga Prokurori i Përgjithshëm, që informon Prokurorinë e Rrethit Kavajë mbi dërgimin e dosjeve përkatëse, nuk mund të zëvendësojë dhe as të njësojë aktin juridik shfuqizues, që ai duhet të përpilojë. Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm për shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale të prokurorit më të ulët, ashtu si çdo akt tjetër juridik kërkon formën e caktuar ligjore. Forma që duhet të ketë një akt juridik përbën një element shumë të rëndësishëm të vlefshmërisë së aktit.

Në rastin konkret, kërkuesi nuk i drejtohet Gjykatës Kushtetuese që të përcaktojë ajo mjetin procedural sesi duhet të pasqyrojë vullnetin Prokurori i Përgjithshëm, siç arsyeton shumica në vendimin e saj, por është detyrë e procesit të gjyimit kushtetues që të konstatojë se forma e kundërligjshme procedurale që ka përdorur prokurori në Prokurorinë e Përgjithshme për shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale, ka sjellë rifillimin e një procesi gjyqësor penal të parregullt. Konstatimi si i gabuar i kësaj procedure të kryer, do të bënte të mundur që i gjithë procesi ligjor të konsiderohej i parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

Anëtar  
Sokol Sadushi

**V E N D I M**  
**Nr.144, datë 27.6.2003**

**PËR DHËNIE LICENCE**  
**PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “CNA”**

**SUBJEKTIT: SHOQËRIA “CABLE NETWORK ALBANIA” SH.P.K.**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**V E N D O S I:**

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Cable Network Albania” sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen strukturat programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas dhënies së lejes nga ERT-ja dhe botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sefedin Çela**

**V E N D I M**  
**Nr.145, datë 27.6.2003**

**MBI LICENCËN PËR RADIO FM VENDORE PRIVATE “KOHA”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe të nenit 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**V E N D O S I:**

1. T’i heqë subjektit “Media 99” sh.a. licencën me nr.027 FML si operator për transmetim radiofonik vendor privat.

2. Vendimi nr.29/II, pika 22, datë 30.10.2000 i KKRT-së “Mbi licencimin e operatorëve privatë lokalë për televizion analogjik tokësor dhe radio FM”, shfuqizohet.

3. T’i japë subjektit, shoqërisë “Julia & Visi” sh.a., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM privat, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

4. Licenca bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen strukturat programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sefedin Çela**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
  - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

|                                                                                                            |                                                                                                                                                    |                                                                                                                  |                                                                                                  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Kodi Penal</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Mars, 2002               | <b>Kodi i<br/>Procedurës Penale</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Shtator, 2002                                  | <b>Kodi i<br/>Procedurës Civile</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Korrik, 2002 | <b>Kodi Rrugor</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Qershor, 2002 |
| <b>Kodi Penal<br/>Ushtarak</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Tetor, 2002 | <b>Përmbledhëse<br/>legjislacioni<br/>në fushën<br/>e Përmbartimit</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Tetor, 2002 |                                                                                                                  |                                                                                                  |

Doli nga shtypi më 17.7.2003

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4300 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë